



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 550, datë 01.10.2024

**PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË GJYQTARES {...}
PËR DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 01.10.2024 si u njoh me materialet e çështjes, relacionin “Mbi kërkesën e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, për gatitur nga relatorja, znj. Irena Plaku, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Më datë 20.09.2024 znj. {...}, gjyqtare në Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, ka paraqitur “Kërkesën për dhënie leje për kualifikim dhe specializim profesional, për periudhën 05.10.2024 deri në 29.10.2024”, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4486 prot., datë 20.09.2024.
2. Në kërkesën me shkrim znj. {...} parashtron se është nominuar për të marrë pjesë në programin e IVLP, Programi i Liderimit të Vizitorit Ndërkombëtar (International Visitor Leadership Program). Programi për të cilin është nominuar titullohet : “Rule of law and the U.S. Judicial System II”. Programi i Liderimit të Vizitorit Ndërkombëtar (International Visitor Leadership Program) është sponsorizuar nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky program zhvillohet gjatë periudhës 07.10.2024-25.10.2024. Nisja për në SHBA është planifikuar për në datën 05.10.2024 dhe kthimi në Shqipëri është planifikuar për datën 29.10.2024.
3. Gjyqtarja parashtron gjithashtu se deri në momentin e kërkesës ka kryer detyrën me ngarkesë të plotë, duke qenë brenda afateve ligjore dhe se gjatë periudhës së trainimit nuk ka planifikuar procese gjyqësore (përveçse në datën 10.10.2024), duke bërë që veprimtaria ku do të marrë pjesë mos të ndikojë në përmbushjen e detyrave në punë.

4. Bashkëlidhur kërkesës me shkrim, znj. {...} ka paraqitur dokumentacionin mbështetës si më poshtë:

- (i) *Kërkesën e nominuar në emër të gjyqtarës {...}, e cila i është dërguar kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 09.09.2024, nga Ambasada e Shteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*
- (ii) *Ngarkesën e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga data 01.01.2024- 19.09.2024.*

II. PROCEDURA E ZHVILLUAR

5. Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me qëllim trajtimin e kërkesës së gjyqtarit {...}, duke iu referuar parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 72, datë 20.02.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, i kërkoi i Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, informacion në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve të kësaj gjykate si dhe mendimin e tij lidhur me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës. Gjithashtu, i kërkoi kancelares së gjykatës, informacion në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjyqtarit {...}.

6. Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, nëpërmjet postës elektronike, datë 27.09.2024, ka përcjellë mendim, duke parashikuar se; “Për sa i përket kërkesës së gjyqtare {...} për leje të papaguar për arsye specializimi, nëse cenohet ose jo funksionalitetit, mendoj se nuk cenohet dhe nuk shkakton efekte negative në funksionimin e gjykatës”.

7. Sa i përket ngarkesës aktuale të gjyqtarës {...}, sipas të dhënave të dërguara nga vetë gjyqtarja, rezulton se :

1. Gjyqtarja {...} aktualisht ka në shqyrtim 459 çështje.
2. Deri në datë 19.09.2024 ajo ka përfunduar së gjykuari 463 çështje.

8. Nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, veç kërkesës së gjyqtarës dhe provave bashkëngjitur saj, u administruan të dhënat e dosjes personale të gjyqtarës.

9. Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarinë Profesionale, zhvilloi procedurën administrative në përputhje me pikën VI të Vendimit Nr. 72 dt. 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, brenda 7 ditëve nga depozitimi i kërkesës së gjyqtarit dhe në mbledhjen e datës 27.09.2024 vendosi që kjo çështje t’i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

10. Kjo kërkesë u mor në shqyrtim në Mbledhjen Plenare të Këshillit më datë 01.10.2024, brenda afatit 15 ditor nga paraqitja e propozimit në referim të parashikimeve të pikës 6 shkronja “b” të Vendimit nr.72 datë 20.05.2019 të KLGJ.

III. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

11. Në nenin 24, paragrafi 3 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, përcaktohet se: “3. Magjistrati mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 vjet për qëllime kualifikimi profesional dhe specializime në një institucion trajnimi, ose për arsye familjare ose shëndetësore. Leja e papaguar mund të merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme sipas kërkesës së magjistratit”.

12. Në vendimin nr. 72 datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, përcaktohen kriteret dhe procedurat e dhënies së këtyre lejeve. Lidhur me kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për arsye familjare dhe/ose shëndetësore, pika 6 e vendimit të sipërcituar parashikon si vijon:

6. *Leja për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jepet nga Këshilli për një periudhë jo më shumë se dy vjet, si me poshtë:*

- a. *Gjyqtari që kërkon këtë leje, paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes për ndjekjen e këtij trajnimi, afatin e lejes dhe të dhëna për institucionin trajnues. Kërkesës duhet t’i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues si dhe mendimi me shkrim nga kryetari i gjykatës në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës;*
- b. *Kërkesa e gjyqtarit trajtohet nga Komisioni përkatës, i cili brenda 7 ditëve i përcjell Mbledhjes Plenare propozimin për miratimin ose refuzimin e lejes. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit;*
- c. *Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh, ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së gjyqtarit, por në total jo më shumë se 2 vjet. Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short, të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim;*
- d. *Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, nëse kualifikimi profesional ose specializimi nuk përputhet me funksionin e gjyqtarit, ose nëse ajo bie ndesh me interesat kryesore të funksionit dhe vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.*

IV. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

13. Ligji për Statusin, si pjesë e garancive të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës që kanë për qëllim të sigurojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor, përveç pushimeve vjetore, ka parashikuar edhe të drejtën e magjistratit për të përfituar pushime të tjera. Në këtë kontekst neni 24 i këtij Ligji ka si qëllim

që, nëpërmjet përcaktimit të llojeve të pushimeve të tjera dhe rregullave për marrjen e tyre, të krijojë kushtet e përshtatshme për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, i cili nuk është privilegj apo qëllim në vetvete, por i shërben garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër dispozita ka pasur si qëllim të mbrojtë edhe të drejtën e marrjes së pushimeve të tjera nga magistratët, veç lejen e tyre vjetore, duke e parashikuar një të drejtë të tillë drejtpërdrejt në ligj, çka e bën atë element të garancive funksionale për magistratët.

14. Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, neni 24 i Ligjit nr.96/2016 dhe Vendimi nr.72 datë 20.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në pikën 4, parashikojnë tre lloje të lejes dhe konkretisht :

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. Leje për arsye familjare dhe/ose shëndetësore;

15. Në kërkesën e saj, Znj. {...} parashtrohet se kërkohet leje e papaguar për arsye kualifikimi dhe specializimi, sipas përcaktimeve të nenit 24, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

16. Sa i përket kushteve për dhënien e lejes për arsye familjare, sipas parashikimeve të pikës 6 të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në rastin konkret, rezulton se:

- a. Gjyqtari që kërkon lejen duhet të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Këshillit të paktën 30 ditë para fillimit të lejes së kërkuar. Në rastin konkret gjyqtarja ka paraqitur kërkesën me shkrim në datën 20.09.2024 ndërkohë që leja kërkohet të fillohet në datën 05.10.2024. Pra, kërkesa është paraqitur në më pak se 30 ditë para kohës së fillimit të specializimit për të cilat kërkohet dhënia e lejes. Por, bazuar në shkresat provuese të dërguara nga gjyqtarja, duke marrë në konsideratë që dita në të cilën i është njoftuar ky nominim kryetares së Këshillit mban datën 09.09.2024 (pra më pak se 30 ditë nga data e fillimit të lejes së papaguar), kërkesa e Znj. {...} nuk mund të bëhej 30 ditë para fillimit të lejes.
- b. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes për të cilën kërkohet leja, kohëzgjatjen saj dhe të dhëna për institucionin pranë të cilit do të zhvillohet aktiviteti kualifikues. Në rastin konkret, në kërkesën e gjyqtarës përcaktohet qartë arsye e kërkimit të lejes që konsiston në pjesëmarrjen e saj në Programin e Lidërshipt të Vizitorit Ndërkombëtar të nominuar nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Tiranë. Gjithashtu është përcaktuar qartë kohëzgjatja e lejes nga data 07.10.2024 deri në datën 25.10.2024.
- c. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin justifikues si dhe mendimin e kryetarit të gjykatës për cenimin ose jo të funksionaliteti të gjykatës. Në rastin konkret kërkesa e gjyqtarës {...} është shoqëruar me dokumentacion justifikues që konsiston në kualifikimin dhe specializimin profesional në kuadër të Programit të Lidërshipt të Vizitorit Ndërkombëtar. Gjithashtu është paraqitur nëpërmjet postës elektronike datë 27.09.2024 mendimi i

zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në të cilin theksohet se: “Për sa i përket kërkesës së gjyqtare {...} për leje të papaguar për arsye specializimi, nëse cenohet ose jo funksionalitetit, mendoj se nuk cenohet dhe nuk shkakton efekte negative në funksionimin e gjykatës”.

Lidhur me cenimin e funksionalitetit të gjykatës, veç mendimit të zëvendëskryetarit parashtruar më sipër, është administruar informacion lidhur me ngarkesën aktuale të gjyqtarës nga i cila rezulton se ka në shqyrtim 459 çështje.¹

- d. Leja e kërkuar të mos kalojë afatin maksimal prej 2 vjetësh. Në rastin konkret leja e kërkuar është për një periudhë më të shkurtër se dy vjet dhe konkretisht për periudhën 05.10.2024 deri në 29.10.2024 (24 ditë).
- e. Kualifikimi profesional të mos ketë mospërputhje me funksionin e gjyqtarit ose të mos bjerë ndesh me interesat kryesore të funksionit dhe vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë. Lidhur me këtë kriter, nga informacioni i përcjellë bashkëlidhur kërkesës rezulton se kualifikimi/specializimi të cilin gjyqtarja do të finalizojë nëpërmjet pjesëmarrjes në programin si më sipër, është në fushën e ligjit dhe për pasojë, nuk rezulton të mos ketë mospërputhje me funksionin e gjyqtarit apo të bie ndesh me interesat kryesore të funksionit të saj. Pjesëmarrja e gjyqtarës në Programin e Liderimit të Vizitorit Ndërkombëtar vlerësohet se nuk ka mospërputhje me funksionin e gjyqtarit dhe nuk bie ndesh me interesat kryesore të funksionit.

17. Për sa më sipër, vlerësohet se;

- kërkesa e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar për arsye kualifikimi dhe specializimi, për një periudhë më pak se një muaj, nga data 05.10.2024 deri në 29.10.2024 përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24, të ligjit nr. 96/2016 dhe vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”.
- arsyeja për këtë leje, e paraqitur nga gjyqtarja, është e pranueshme, pasi lidhet drejtpërdrejtë të drejtën e saj për të kryer kualifikimi në fushën përkatëse ku ka shprehur interes.
- mungesa e gjyqtarës në ushtrimin e funksionit të saj pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, për shkak të ngarkesës që ka ajo si gjyqtare, masat që ajo ka marrë për të mos pasur shumë gjykime të planifikuar gjatë periudhës kur ajo do të jetë për specializim dhe e gjithë gjykata në tërësi, **nuk vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.**

18. Sa i përket çështjeve gjyqësore të cilat gjyqtarja {...} ka në shqyrtim në kreun VII, pika 8, shkronja ç) të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019, parashikohet se: “Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim”. Në këtë kuadër vlerësohet se çështjet që gjyqtarja ka në shqyrtim **ditën e fillimit të lejes së papaguar**, duhet t’i mbeten asaj për shkak të periudhës së shkurtër për të cilën kërkohet leja. Lidhur me parashikimet e nenit 25, pika

¹Sipas informacionit dërguar bashkangjitur kërkesës nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se gjyqtarja {...} ka në gjykim 558 çështje, nga të cilat 544 çështje civile themeli, 10 kërkesa civile dhe 4 kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi. Ndërsa sipas të dhënave të tabelës që jep ngarkesën e gjyqtarës rezulton se ajo ka në gjykim 459 çështje, nga të cilat 450 janë çështje familjare dhe 9 kërkesa civile.

3, shkronja d) të Ligjit 98/2016, ku rindarja e çështjeve me short lejohet kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara, bazuar sa më lart, duke qenë se koha e lejes së papaguar është shumë e shkurtër dhe ngarkesa e gjyqtarëve të tjerë në detyrë është shumë e lartë, rekomandohet që dosjet e Znj. {...} të mos rishortohen, por t'i mbeten asaj.

19. Sa i përket përjashtimit të gjyqtarës {...} nga procedurat e shortimit të dosjeve që regjistrohen në gjykatë, gjatë periudhës së lejes së papaguar, në kreun V, pika 2, të vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 *“Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”* të Këshillit të Lartë Gjyqësor parashikohet se: *“Kryetari i Gjykatës, pas kërkesës së motivuar të gjyqtarit, mund të përjashtojë nga shorti pjesërisht apo tërësisht gjyqtarin, gjatë lejes së papaguar, me afat deri në 30 ditë. Në këto raste Kryetari i Gjykatës disponon me vendim të arsyetuar”*. Pra sipas kësaj dispozite, është kryetari i gjykatës ai që vendos përjashtimin e gjyqtarit nga shortimi i çështjeve që regjistrohen në gjykatë bazuar në kërkesën e motivuar të gjyqtarit, por deri në një periudhë deri në një muaj. Në këto kushte, parasysh faktin se koha e lejes së papaguar është më e shkurtër se një muaj, ngarkesën e gjyqtarës me çështjet në shqyrtim si dhe duke marrë parasysh ngarkesën e gjyqtarëve të tjerë, ku gjyqtarët e caktuar së fundi normalisht kanë një ngarkesë më të ulët ose nuk kanë fare, vlerësohet se gjatë periudhës së lejes së paguar gjyqtarja duhet të përjashtohet tërësisht nga procedura e shortimi i çështjeve gjyqësore. Përjashtimi i saj nga procedura e shortit nuk çënon parimin e barazisë së shpërndarjes së çështjeve si dhe efikasitetin e drejtësisë në aspektin e respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit.

V. KONKLUZIONI

20. Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se kërkesa e gjyqtarës {...} për dhënien e lejes së papaguar për arsye , për një periudhë nga data 07.12.2023 deri në datën 26.01.2024, përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 96/2016, si dhe vendimit nr.72, datë 20.05.2019 për *“Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”* dhe si e tillë duhet të pranohet.

21. Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100 të Ligjit nr.115/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE;

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61, 68 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, nenin 24, të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, dhe vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 *“Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”*,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së znj.{...}, gjyqtare në Gjykatë në Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi, nga data 05.10.2024 deri në datën 29.10.2024.
2. Përfundimin tërësisht nga shorti i gjyqtarës {...}, gjatë periudhës së lejes së papaguar.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR